



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.85/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohen të bazuara ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.85/2025, Anr.86/202, Anr.88/2025, Anr.106/2025, Anr.107/2025, Anr.108/2025, Anr.109/2025, Anr.115/2025, Anr.116/2025, Anr.117/2025 dhe Anr.118/2025, të datës 21.01.2025.

II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 12.000.000, (dymbëdhjetëmijë) Euro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 21.01.2025 PZAP-i ka pranuar ankesat e identifikuara Anr.85/2025, Anr.86/2025 dhe Anr.88/2025, Anr.106/2025, Anr.107/2025, Anr.108/2025, Anr.109/2025, Anr.115/2025, Anr.116/2025, Anr.117/2025 dhe Anr.118/2025, të datës 21.01.2025.

-Në ankesën Anr.85/2025, pretendohet se në më 20 janar 2025 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, ka identifikuar banerat/posterat të vendosur në rrugën "C", nga kandidati për kryeministër Lumir Abdixhiku si dhe kandidatët për deputetë Izet Sadiku dhe kandidatja Fiknete Bejta, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e

zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit shfrytëzojnë hapësirat në stacionet e destinuara për pritje të autobusëve.

-Në ankesën A.nr.86/2025, pretendohet se më 20 janar 2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, kanë identifikuar banerat/posterat të vendosur në rrugën "C" disa kandidatë për deputetë nga lista e Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndër ta edhe kryetari i këtij subjekti Lumir Abdixhiku, dhe kandidati Shkëmb Manaj, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit shfrytëzojnë hapësirat në stacionet e destinuara për pritje të autobusëve.

-Në ankesën Anr.88/2025, pretendohet se më 20 janar 2025 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, kanë identifikuar banerat/posterat të vendosur në rrugën "Hemine Lekaj"(te banesat e bardha-bregu i diellit) disa kandidatë për deputetë nga lista e Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndër ta edhe kryetari i këtij subjekti Lumir Abdixhiku, kandidatët Sokol Havolli dhe Doruntinë Maloku, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit shfrytëzojnë hapësirat në stacionet e destinuara për pritje të autobusëve dhe më të njëjtin veprim konsiderojmë se janë shkelur dispozitat ligjore të nenit 34, paragrafi 1,nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP,

-Në ankesën Anr.106/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për kryeministër Lumir Abdixhiku, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur hapësirat publike, konkretisht në rrugën "Afrim Zhitia", në Prishtinë, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit shfrytëzojnë hapësirat në stacionet e destinuara për pritje të autobusëve

-Në ankesën Anr.107/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, ka identifikuar banerat/posterat e kandidatit për kryeministër Lumir Abdixhiku, dhe kandidatët për deputet Arben Gashi, Doarsa Kica Xhelili, Besian Mustafa, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur në hapësirat publike, konkretisht në rrugën "Xheladin Rekaliu", në Prishtinë, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit kanë shfrytëzuar hapësirat në stacionet e destinuara për pritje të autobusëve.

-Në ankesën Anr.108/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për kryeministër Lumir Abdixhiku, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, si dhe shenjat identifikuese zgjedhore me numër 124", të vendosur në hapësirat publike, konkretisht në rrugën "Enver Maloku" në Prishtinë, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit kanë shfrytëzuar hapësirat në stacionet e destinuara për pritje të autobusëve.

-Në ankesën Anr.109/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për kryeministër Lumir Abdixhiku, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, si dhe shenjat identifikuese zgjedhore me numër 124”, të vendosur në hapësirat publike, konkretisht në rrugën “Fehmi Lladrovci” në Prishtinë, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit kanë shfrytëzuar hapësirat në stacionet e destinuar për pritje të autobusëve.

-Në ankesën Anr.115/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, ka identifikuar banerat/posterat e kandidatit për kryeministër Lumir Abdixhiku, dhe deputetëve Sokol Havolli, Doruntinë Maloku, Alban Zogaj E.Nikç-Rexha, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, si dhe shenjat identifikuese zgjedhore me numër 124”, të vendosur në hapësirat publike, konkretisht në rrugën “Enver Maloku” në Prishtinë, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit kanë shfrytëzuar hapësirat në stacionet e destinuar për pritje të autobusëve.

-Në ankesën Anr.116/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për kryeministër Lumir Abdixhiku, dhe deputetëve Hykmete Bajrami, Besian Mustafa dhe kandidat të tjerë afër Sallës 1 Tetori, tek Konviktet nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur në hapësirat publike, konkretisht në rrugën “Xheladin Rekalu” në Prishtinë, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit kanë shfrytëzuar hapësirat në stacionet e destinuar për pritje të autobusëve.

-Në ankesën Anr.117/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për kryeministër Lumir Abdixhiku, dhe deputetëve Besian Mustafa, Doarsa Kica Xhelili dhe kandidat të tjerë, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur në hapësirat publike, konkretisht në rrugën “Arbnor dhe Astrit Dehari” në Prishtinë, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit kanë shfrytëzuar hapësirat në stacionet e destinuar për pritje të autobusëve.

-Në ankesën Anr.118/2025, pretendohet se më datë 20 Janar 2025, ka identifikuar banerin/posterin e kandidatit për kryeministër Lumir Abdixhiku, dhe deputetëve Sibel Halimi, Besian Mustafa, Arben Gashi dhe kandidat të tjerë, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur në hapësirat publike, konkretisht në rrugën “Eqrem Qabej” në Prishtinë, duke shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me mbarëvajtjen e zgjedhjeve, hapësirat publike, konkretisht të njëjtit kanë shfrytëzuar hapësirat në stacionet e destinuar për pritje të autobusëve.

Me këto veprime kandidatët dhe Subjekti Politik LDK, kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP.

Parashtruesi i ankesës po ashtu në ankesë thekson se pas të drejtës për qasje në dokumente zyrtare, si palë e interesuar ka kërkuar nga organi kompetent që ka në menaxhim këto hapësira, konkretisht Sektorin për Shërbime Publike në Komunën e Prishtinës, të njëjtit e kanë njoftuar se subjekti politik LDK, nuk posedon leje përkatëse për shfrytëzimin e hapësirave dhe si organ komunal Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk ka lëshuar ende asnjë leje përkatëse për reklamime. Si provë për pretendimet në ankesa, parashtruesi ka bashkangjitur fotografi që dëshmojnë vendosjen e banerave/posterave dhe komunikimin në kundërshtim me LZP

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, thekson se pretendimet e Lëvizjes Vetëvendosje se subjekti i tyre LDK dhe disa prej kandidatëve për deputet me rastin e vendosjes së materialeve reklamuese në pritore kanë shkelur nenin 34 paragr. 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme konsiderojnë se ligjërisht nuk qëndron. Më tutje thuhet se nga kufizimet e mësipërme nuk ka të bëjë me rastet e ankesave të parashtruara nga subjekti LVV, se pse në të gjitha rastet kanë të bëjnë me pritoret nëpër kryeqytet dhe për këtë çështje ekziston fillimisht kontrata e lidhur në mes të Komunës së Prishtinës, gjegjësisht Drejtorisë së Shërbimeve Publike me operatorin ekonomik "Selman Network" i cili ndër tjerash ka për obligim që sipas kontratës furnizimin me pritore, mirëmbajtjen, menaxhimin e tyre dhe dhënien për shfrytëzim të këtyre hapësirave reklamuese. Në vazhdim thuhet se kontrata tjetër e bashkangjitur në përgjigjen në ankesë, si provë e dytë për rastet në fjalë është kontrata e lidhur mes operatorit ekonomik dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës si deh shtojcat e kontratës, të cilat dëshmojnë për kontaktimin e këtyre prit orëve në kuptimin e shfrytëzimit të hapësirave reklamuese.

Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), në përgjigjen e saj ka bashkangjitur si provë:

- Kontrata e lidhur në mes të komunës dhe operatorit ekonomik" Selmans Network".
- Përgjigja me shkrim (email zyrtar) nga Drejtoria e Shërbimeve Publike
- Kontrata për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese dhe Shtojca, e lidhur në mes të Selmans Network dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)

Sipas përgjigjes në ankesë theksohet se asnjë nga kufizimet e nenit 7 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar nuk ka të bëjë me rastin në fjalë dhe as nuk ndërlidhen.

Po ashtu në përgjigjen e subjektit politik LDK, është përfshirë rasti i subjektit politik LVV i cili nuk është dënuar, është Vendimi i PZAP-it Anr.74/2025 ( vendosja e shtëpizës në sheshin Nëna Tereza për të cilën subjekti ka marrë leje në atë komunë dhe po ashtu edhe subjekti jonë ka kontratë për shfrytëzim të hapësirave reklamues me operatorin ekonomik-Selman Network, për më tepër ekziston edhe sqarimi me shkrim nga drejtoria përkatëse. Kërkojnë nga PZAP-i, të marrë vendim meritore për rastin në fjalë duke u bazuar në krejt ato që u thanë që ankesa e subjektit LVV të refuzohet sie pabazuar.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.85/2025, A.nr.86/2025, A.nr.88/2025

Anr.106/202, Anr.107/2025, Anr.108/2025, Anr.109/2025, Anr.115/2025, Anr.116/2025 Anr.117/2025 dhe Anr.118/2025 të paraqitura me datë 21.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.85/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat, gjeti se :

-Ankesat janë të bazuara.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndëve dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Në përgjigje në ankesë të Subjektit Politik LDK, referuar disa prej kandidatëve për deputet nga ky subjekt, pretendohet se për vendosjen e materialeve reklamuese-postereve posedojnë Kontratë me Operatorin Ekonomik Selman Network, SH.P.K, me nr.Prot.01/2025, datë 11 Janar 2025, e bashkangjitur si provë në përgjigje në ankesë.

Paneli gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht Kontratës së LDK-së me Operatorin Ekonomik Selman Network, SH.P.K, të datës 11 Janar 2025, ka vërejtur se e njëjta kontratë nuk përmban asnjë të dhënë se operatori ekonomik në fjalë të ketë lidhë ndonjë kontratë me Komunën e Prishtinës për shfrytëzimin e këtyre hapësirave publike reklamuese, përkatësisht për të pasur të drejtë që të njëjtat hapësira reklamuese t’ia bartë personit të tretë. Nga komunikimi elektronik që përmban emrin Arlinda Kastrati, Zyra për Komunikim Publikë të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, drejtuar Ermal Osmani, datë 13.01.2025, paneli vëren se Sektori për Shërbime Publike nuk posedon ndonjë kontratë për hapësirat reklamuese në pritoret a autobusëve. Gjithashtu, nuk është lëshuar asnjë leje për shfrytëzimin e hapësirave të tjera publike për reklamim. Po ashtu nga komunikimi elektronik në mes të Habib Qorri, udhëheqës i Sektorit Për Shërbime Publike në Komunën e Prishtinës, drejtuar Donat Lushaku, është pohuar se ekziston Kontrata publike Kornizë Publike – Furnizime datë 30.10.2019, e lidhur në mes të Komunës së Prishtinës në njërën anë, dhe Selman Network sh.p.k, e cila është ende në fuqi dhe realizim. Pas konsultimit me menaxherin e kontratës, pritoret janë furnizuar dhe montuar nga shtatori i vitit të kaluar 2024 në kryeqytet, ku në bazë të kontratës pas furnizimit, montimit dhe funksionalizimit të pritoreve, operatori ekonomi Selman Network sh.p.k ka për obligim mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre dhe për tri vite, përfshirë këtu edhe hapësirën reklamuese.

Marrë për bazë përgjigjet e tilla kundërthënëse për raportin kontraktues mes tyre, përkatësisht të drejtat dhe detyrimet nga ky raport, PZAP me datë 23.01.02025 ka kërkuar

sqarime nga Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Shpëtim ka dhënë përgjigje në kërkesë, ku ndër tjera ka theksuar se: *“Sektori për shërbime Publike, nuk ka lëshuar dhe nuk posedon ndonjë kontratë për hapësirat reklamuese ne pritore e autobusëve. Gjithashtu nuk është lëshuar leje nga ky për shfrytëzimin e këtyre hapësirave publike reklamuese...”*”.

Nga arsyet e paraqitura rezulton se Selman Network sh.p.k nuk ka pasur kontratë të vlefshme me Komunën e Prishtinës për shfrytëzimin e pritoreve dhe hapësirave të tjera, dhe rrjedhimisht nuk ka pasur mundësi që një të drejtë të tillë t’ia bartë tjetrit, në këtë rast subjektit politik PDK. Mbi këtë bazë është vlerësuar se kontrata e lidhur mes operatorit ekonomik Selman Network sh.p.k dhe subjektit politik LDK nuk mund të prodhojë efekt juridik në kuptim të krijimit të bazës për shfrytëzim të këtyre hapësirave, përkatësisht vendosjen e posterëve, sepse për vendosjen e posterëve nevojitet të merret leja nga organet kompetente Komunale.

Paneli ka vlerësuar se vendosja e posterave nga subjekti politik LDK respektivisht kandidatet e këtij subjekti në hapësirat publike, në mungesë të lejes përkatëse të lëshuar nga Komuna e Prishtinës i konsideron si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në hapësira publike gjeëgjësisht në rrugët publike për të cilat nuk posedojnë Pëlqim nga Komuna e Prishtinës, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën saktësisht e sanksionuar me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe të njëjtit subjekt politik për të njëjtën shkelje i është shqiptuar gjobë nga PZAP gjatë këtij procesi zgjedhor.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.85/2025 datë 24.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.





## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.19/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Muhamet Rexha, kryetar, Beshir Islami dhe Ragip Namani, anëtarë, në çështjen juridike lidhur me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.85/2025, të datës 24.01.2025, në seancën e mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë:


### A K T V E N D I M

HEDHET si e pasafatshme ankesa e Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.85/2025, të datës 24.01.2025.

### A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.85/2025, të datës 24.01.2025, është vendosur: I. Pranohen të bazuara ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.85/2025, Anr.86/202, Anr.88/2025, Anr.106/2025, Anr.107/2025, Anr.108/2025, Anr.109/2025, Anr.115/2025, Anr.116/2025, Anr.117/2025 dhe Anr.118/2025, të datës 21.01.2025. II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 12.000.000, (dymbëdhjetëmijë) €. III. Detyrohet Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Subjekti Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke propozuar që Gjykata Supreme ankesën ta aprovojë si të bazuar, dhe



ta anuloi tërësisht vendimin e PZAP-se, A.nr.85/2025, të datës 24.01.2025, në kuptimin edhe të heqjes së plotë të gjobës së shqiptuar.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të dënuar me këtë vendim të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi Anr.85/2025, i datës 24.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 21.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuar Anr.85/2025, Anr.86/2025 dhe Anr.88/2025, Anr.106/2025, Anr.107/2025, Anr.108/2025, Anr.109/2025, Anr.115/2025, Anr.116/2025, Anr.117/2025 dhe Anr.118/2025, të datës 21.01.2025.


Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), PZAP-i, ka nxjerr vendimin Anr.85/2025, të datës 24.01.2025, me të cilën i ka aprovuar ankesat e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.85/2025, të datës 24.01.2025, Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka paraqitur ankesë, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e ankesës dhe konstatoi se në këtë rast ankesa është e pasafatshme, për arsye se:

Me neni 118, paragrafi 4, të Ligji nr. 08/I-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: “Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP-ja, mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se ankesa nuk lejohet kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.85/2025, të datës 24.01.2025, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së ankesës të kushtëzuar përveç tjerash edhe me afatin për paraqitjen e ankesës i cili është dyzet e tetë (48) orë nga pranimi i vendimit të PZAP-së, për të qenë e lejuar ankesa.





Në këtë rast nga shkresat e lëndës konstatohet se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës konstatohet se vendimin subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e ka pranuar më datën 25.01.2025 në orën 09:20h., ndërsa ankesën kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, subjektit politik (LDK), e ka dorëzuar në Gjykatën Supreme më datë 28.01.2025 në ora 10:50h, e që rrjedhimisht rezultton se ankesa është dorëzuar pas kalimit të afatit prej dyzet e tetë (48) orëve. Në këtë rast afati për paraqitjen e ankesës fillon të llogaritet nga data 25.01.2025 ora 10:20h, ndërsa koha e fundit e afatit për paraqitjen e ankesës ka qenë 27.01.2025, ora 11:50h, prandaj në këtë rast, ankesa është e palejuar, për shkak se është paraqitur pas afatit ligjorë prej dyzet e tetë (48) orëve.

Nga arsyet e paraqitura më lart, e në bazë të nenit 118.4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.19/2025, më datë 01.02.2025.

Kryetari i kolegjit

Muhamet Rexha





SEKRETARIATI KËSHILLIT GJYEQSOR TË KOSOVËS

Sheji i shkresës  
Oznaka spisa:

Oznaka spisa: 01.02.2025

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLJANJE

4  
4  
2  
0  
2  
1

I. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjete në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas tëjës së lapinimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në bonesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdesarit të ndërrës, fëmijë, personit që punon po natë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavještenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odaslom članu domaćin, primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu, primaocu

2. Pasi marrësi ose anëtarë i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pisno je dostavljeno u staru - radnomu mestu primaoca ( pribežno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Mē \_\_\_\_\_ 201 \_\_\_\_\_ nē ora \_\_\_\_\_ cas.  
dana \_\_\_\_\_ u \_\_\_\_\_

Shkaku i refuzimit të martesës  
Razlog adibijanja priiimea

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

(Të panevojshmeve bjerri vizë - nepotrebne precitati)

Emri i shkresës që dorëzohet:  
Naslov pisma koja se dostavlja:

Numri i shtojcave:  
broj priloga

Vērtētoji se mora shķresēn e lartēpēmendur  
mē (mē fjalē)  
Povēdujemo prijem gorenavegenog pisma  
(i slovina)

(Nënshkrimi i marrësit ose i tij që  
e ka marrë aktin në vend të tij  
Përpis primocia ili lica koje je  
pisмено primilo u zamenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Ne pasti se martesti šehite martilaci ose nuk ebite ne gjenide te nimen hkrutaje doretusi, duke shënuar shënim pse martesti nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primtaci neprisem illi nje e stanje da se poftice, porpsitje ge dostalac, napomenom zaslo primtaci nje stavio svoi poftis.